**VENDIM**
**Nr. 126, datë 13.3.2019**

# PËR MBYLLJEN E NDËRMARRJES SHTETËRORE "QENDRA NDËRKOMBËTARE E KULTURËS "ARBNORI""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës publike", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e ndërmarrjes shtetërore "Qendra Ndërkombëtare e Kulturës "Arbnori"".
2. Ngarkohet Qendra Ndërkombëtare e Kulturës "Arbnori" të likuidojë detyrimet ndaj të tretëve.
3. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 286, datë 8.8.1991, "Për krijimin e Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës", dhe nr. 384, datë 6.3.2009, "Për mbylljen e përkohshme të veprimtarisë së ndërmarrjes shtetërore "Qendra Ndërkombëtare e Kulturës "Arbnori"", shfuqizohen.
4. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**